



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.253/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “NEW LINE” sh.p.k me seli në Prishtinë, me nr. të biznesit 71048845, të cilën me autorizim e përfaqëson Hidajete Mazhiqi avokate, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit të Nr. PSH. 780/19 i datës 02.12.2019, në rivendosje, jashtë seancës, konform nenit 33 paragrafi 2 te Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktin Administrativ, me datë 31.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HEDHET** poshtë padia e paditësit “NEW LINE” sh.p.k me seli në Prishtinë, me nr. të biznesit 71048845, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit të Nr. PSH. 780/19 i datës 02.12.2019 **si e paplotësuar.**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Me datë 20.12.2019 paditës “NEË LINE” sh.p.k me seli në Prishtinë, me nr. të biznesit 71048845, të cilën me autorizim e përfaqëson Hidajete Mazhiqi avokate, ka parashtruar padi kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit të Nr. PSH. 780/19 i datës 02.12.2019. Padi është parashtruar në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative dhe është evidentuar me nr. A.3047/19.

Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA 107/22.

Gjykata me aktvendim të datës 07.10.2022 paditësit ia ka kthyer në plotësim padinë me kërkesë ta dorëzoj vendimin e goditur me padi dhe ti bashkëngjisë ti gjitha provat.

Në seancën e datës 14.11.2023 gjykata konstatoj se e paditura e ka kthyer një parashtrese ne gjykatë me datë 16.01.2023 por që të njëjtës nuk ia ka bashkëngjitur vendimin e kundërshtuar dhe deklaron se as në seancë nuk mund ta dorëzoj sepse nuk e ka dhe duhet ta kërkoj nga paditësi.

Prandaj u konstatua se përfaqësuesja e paditësi është njoftuar me aktvendim të gjykatës të datës 07.11.2022 me të cilin është kërkuar në mënyrë specifike vendimi i kundërshtuar dhe po ashtu është njoftuar për pasojat e mos dorëzimit dhe mënjanimi të metave të padisë, mirëpo përkundër kësaj nuk ka vepruar sipas aktvendimit të gjykatës.

Gjykata duke vepruar sipas Nenit 33, paragrafi 2 i LKA-së ku përcaktohet se *nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm*, me aktvendim të datës 12.12.2023 vendosi te hedh padinë si te paplotësuar sepse ne procedure te administrimit te provave nuk kishte se si te vlerësoj ligjshmërinë e vendimit te kundërshtuar.

Ne procedure sipas ankese Shkalla e dyte e Gjykatës Komerciale me Aktvendim K.DH.SH.II.nr te datës 28.03.2024 e ka prishur Aktvendimin e datës 12.12.2023, me konstatim se gjykata e shkalles se para nuk i ka dhëne mundësi palës te dorëzoj provën – vendimin e kundërshtuar, dhe ka vlerësuar se gjykata e ka shkelur nenin 33 par.2 te LKA-se.

Ne procedure te rivlerësimit, gjykata e shkalles se pare, sqaron se nuk është e vërtete se palës nuk i është dhëne mundësia për ta dorëzuar provën, dhe ky konstatim vërtetohen bindshëm sepse ne dosje te lendes janë te gjitha provat: **Aktvendim i datës 07.10.2022, me të cilin paditësit ia ka kthyer në plotësim padinë me kërkesë ta dorëzoj vendimin e goditur me padi (specifikisht te theksuar ne piken I te aktvendimit) dhe ti bashkëngjisë te gjitha provat.** Ky aktvendim eshte

pranuar nga përfaqësuesja e autorizuar e paditësit me date të shënuar me shkrim (trembëdhjetë 2022), e nënshkruar nga Hidajete Mazhiqi avokate.

Pra gjykata të njëjtën e ka ftuar ta dorëzojë vendimin e kundërshtuar, brenda afatit të caktuar dhe e ka njoftuar në mënyrë të detajuar për pasojat ligjore nëse nuk dorëzohet vendimi i kundërshtuar.

Për më tepër fakti se e njëjta është ftuar në seance me datë 14.11.2023 nënkupton se i është dhënë edhe një mundësi për ta dorëzuar vendimin. Por që në seance përfaqësuesja e paditësit në cilësi të avokates prezenton pa shkresa të lendes.

Tani gjykata e shkallës së dytë udhëzon që të njëjtës, ti ipet edhe një mundësi, me arsyetim se pala ka deklaruar “*vendimin sot nuk e kam por do të konsultohem me paditësin*”.

Kjo gjykatë udhëzimit gjykatës së shkallës së dytë që të njëjtës pale ti ipet edhe një mundësi e vlerëson trajtim të padrejtë në raport me trajtimin e palëve të tjera, përderisa shumë lende të tjera që janë në pritje për një kohë të gjatë palët nuk kanë pas ende mundësi të paraqiten në gjykatë, e njëjta njëjta pale ka pasur hy mundësi që të dorëzojë dokumentin e bashkëngjitur, një herë siç është e ftuar me aktvendim të datës 07.10.2022 dhe herën e dytë kur është ftuar në seance me datë 14.11.2023. Deklarimi i palës “*vendimin sot nuk e kam por do të konsultohem me paditësin*”, nuk përben asnjë arsye të bazuar për çka gjykata do duhej të merrte në konsideratë, sepse paditës e ka për detyrim ligjor që padinë ta dorëzojë me të gjitha provat në momentin kur iniciohet procedura në gjykatë. Në nenin 30 paragrafi 1 të LKA-së përcaktohet:

*Në padi duhen të përfshihen: emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia, emri, mbiemri dhe vendbanimi, respektivisht selia e paditësit dhe e të paditurit, **akti administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, arsyet pse ngrihet padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ. Bashkë me padinë duhet të bashkëngjitet akti që kontestohet në origjinal ose kopje.***

Prandaj, bazuar në Nenin 33, paragrafi 2 i LKA-së, u vendos si në diapozitiv e këtij aktvendimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.253/24, datë 31.05.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.